



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 28, datë 05.03.2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA "BAJRAM TUSHA" I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019


Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" (Titulli 3, Bashkëpronësia, Neni 199 dhe vijues), të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raporteve të Komisionit të Posaçëm, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 458, Rruga "Bajram Tusha" në Njësinë Administrative Nr. 5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e raportit të Komisionit të Posaçëm me nr. 2145/8 prot., datë 04.03.2021 për Pallatin nr. 458, Rruga "Bajram Tusha" në Njësinë Administrative Nr. 5, për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, bashkëlidhur.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.03.2021

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE PALLATI 458 RRUGA "BAJRAM TUSHA"

Nr.	PRONARI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS
1	ILIRJAN LICOLLARI, ENRIKETA LICOLLARI	4	2+1
2	QEMAL MEHMET ARAPI, ENKELEID MEHMET ARAPI	2	1+1
3	XHEVRIJE XHEMAL SALIHI, PRANVERA NEKI SALIHI	4(1+3)	2+1
4	GAZMEND TAHIR MENA	3	2+1
5	DENIS MUHO	5	3+1
6	SHABAN VEI I RAKIPI, NURIJE ALI RAKIPI	2	1+1
7	SAJMIR BACAJ	4	2+1
8	FEIM DISHA	5	3+1
9	JOVAN VASIL BACI	4	2+1
10	GJERGJ ZEF LUGJA	3	2+1
11	ISMETE SERVET BODLI	2	1+1
12	STAVRI JORGO TILI, KRISTINA PIPO TILI	1	1+1
13	PROKOP SPIRO NUSHI, LLAMBRINI SPIRO NUSHI	4	2+1
14	MENDIJE ZAIM SHARKA	3	2+1
15	ALBERT ONUZI, BUKURIJE ONUZI	8	3+1
16	BEJTE KACANIKU	1	1+1
17	KADRI RAMAZAN THERTORI	2	1+1
18	ALI CENOLLARI, ASIME CENOLLARI	6	3+1
19	GEZIM MUSTAFA HOXHA	5	3+1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 2145/Prot.
8

Durrës, më 04 . 3 . 2021



RAPORT

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË PËRFITUESVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458 RRUGA "BAJRAM TUSHA" E DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

E nderuar zonja Kryetare,

Sikurse jeni në dijëni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Durrës, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Durrës, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat "a" dhe "d" institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Zyre të Posaçme të Rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve dhe kualifikimin e tyre si dhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

- Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuesit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëme të cilat ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimitin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”.

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, i ngritur me urdhër nr. 108, datë 12.03.2020 të Zëvendëskryetarit të Bashkisë, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve të pallatit nr.458 rruga "Bajram Tusha",

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posaçme e Rindërtimi, nëpërmjet

1. Raportit nr. 2145/7 prot. datë 04.03.2021 për Pallatin Nr. 458 Rruga "Bajram Tusha" ku kanë kualifikuar 19 subjekte përfituese, ku të gjitha subjektet kanë aplikuar në platformën "Shtëpia Ime" dhe është marrë gjendja familjare e datë së aplikimit.


Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Për sa më sipër, lista e subjekteve përfituese, pjesë përbërëse e këtij relacioni, është si:

- Aneksi 1 Pallati Nr. 458 Rruga "Bajram Tusha".

KOMISIONI I POSAÇËM:

Florian Tahiri	Kryetar
Ermal Lufo	Anëtar
Andri Cerri	Anëtar
Diana Mandia	Anëtare
Klara Agasi	Anëtare
Edvin Hysi	Anëtar
Afroviti Manthjo	Anëtare
Erjon Meka	Anëtar



BASHKIA DURRËS
23.03.21 N. 209/6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 12 / prot.

Durrës, më 23.03.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 28 datë 05.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 458, rruga ‘Bajram Tusha’ i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

